

Bashkim Lajçi, “Syri i keq në besimet shqiptare”,
Prishtinë, 2013, f. 283.



Para ca kohe në Institutin Albanologjik në Prishtinë, është botuar libri i etnologut Bashkim Lajçi me titull “SYRI I KEQ NË BESIMET SHQIPTARE”. Libri në fjalë përmban 283 faqe. Ky libër është një ndihmesë në fushën e shkencës e posaçërisht në fushën e etnologjisë dhe fushave si motra. Autori sjell prurje të reja në lidhje me besimet shqiptare, duke bërë një studim përmbajtësor në të gjitha krahinat shqiptare. Krahas kësaj, autori studimin e tij e bën edhe më interesant duke përmendur dhe krahasuar besimet e shumë kulturave në vende të ndryshme të botës.

Krahas aspektit teorik, ku është përdorur literaturë e mjaftueshme nga autorët vendore edhe të huaja, libri është i ilustruar edhe me fotografi që e bëjnë këtë botim më të kompletuar. Libri përmban katër kapituj dhe në secilin kapitull trajtohen tema të veçanta.

Kapitulli i parë jep të dhëna të përgjithshme që flasin për syrin e keq si një dukuri e cila është e shfaqur që nga lashtësi. Autori referohet në buri-

met e hershme antike si të Hesiodi, Callimachus, Plato Diodorus, Plini Plak, Aulus Gellius etj. Kryesisht kapitulli i parë ka të bëjë me besimin e njerëzve se si mund të kenë pasoja nga syri i keq, dëmet të cilat mund të shkaktohen nga ky fenomen, protagonistët e kësaj dukurie, efektet e veprimt të syrit të keq, siç janë: mësyshi, mësytë, marrja sysh, etj. Zbërthimin e këtij fenomeni autori nuk e ndalë vetëm të njerëzit, por studimi i tij thellohet duke kaluar të besimi i kafshëve, bimëve, objekteve të vdekura, punës, etj. Temat të cilat trajtohen në këtë libër kanë një përmbajtje si në aspektin teorik ashtu edhe në atë praktik. Sa i përket aspektit praktik këtu shihet puna e palodhshme e studiuesit, punë intenzive në ekspedita kërkimore në mbledhjen e materialeve, intervista të realizuara me subjekte të ndryshme, analizë e veçantë duke klasifikuar materialet. Kapitulli i dytë, ka të bëjë me mbrojtjen e njerëzve nga syri i keq, tërheqja e shikimit të parë, mbrojtja nëpërmjet shenjave apo objekteve, mbrojtja me anë të pastërtisë, mbrojtja me anë të fjalëve. Ky fenomen ka një shtrirje kulturore në të gjitha hapësirat. Për mbrojtje nga syri i keq, njerëzit kanë bërë veprime të shumta magjike, kanë kryer rituale të ndryshme vetëm për ta ndaluar këtë

dukuri. Syri i keq nuk dallon moshë, por ai zakonisht mund të shfaqet më lehtë te fëmijët e vegjël, nusët, gratë shtatzëna, lehonat. Studiuesi na ofron praktika të ndryshme që njerëzit kanë bërë gjatë kohëve të caktuara, si p.sh kur ka lind fëmija i parë atë e kanë mbajtur të fshehur në dhomë, sepse po e pa ndokush fëmijën, ai mund të ketë fatkeqësi të ndryshme. Posaçërisht fëmija është mbrojtur nga personat të cilët anëtarët e familjes kanë besuar se NN, mund të bëjë magji. Pastaj shënohen rituale siç janë: me anë të kri-pës, me dhe, vënia e emrit të rrejshëm, ndërrimi i gjinisë, ndërrimi i kumbarës etj. Autori në secilin paragraf i jep gjallëri punës së tij, bën krahasime të ndryshme me kulturat e tjera. Përveç besimeve të njerëzve autori jep sqarim edhe për besimin në kafshë, ku edhe për këto njerëzit kanë bërë përpjekje që mos ti kapë syri i keq. Këtë gjë e kanë bërë për arsye se një pjesë e të ardhurave të ekonomisë familjare e kanë siguruar nga kafshët, andaj ritualet janë realizuar nga pronarët e tyre. Veprimet të cilat njerëzit i kanë bërë për mbrojtjen e kafshëve janë: Mbrojtja nga shikimi i parë, vënia e ndonjë luge, opinge, hajmalie, penjë me ngjyra të ndryshme në kokë, apo bisht të bagëtisë, janë ndër mënyrat më të përdorura. Krahas njerëzve dhe kafshëve nga shikimi i sykeqit mund të pësojnë edhe bletët, kopshtet, arat dhe vreshtat. Si mjete tjera për mbrojtjen e kopshteve, arave vreshtave nga shikimi i sykeqit, pothuajse kudo në rajon, është konsideruar edhe vendosja e kokave apo rrashtave të kafshëve në tokën e mbjellë. Mbrojtja nëpërmjet shenjave apo

objekteve të vendosura në trup! Kjo dukuri e praktikuar në vende të ndryshme, por edhe në kulturën shqiptare, me theks të veçantë lyerja e fytyrës me ngjyrë të zezë, është besuar si mbrojtje e mirë nga syri i keq, më pastaj kemi ngjyrën e kuqe, të kaltër, dhe kombinimin e ngjyrave.

Kapitulli i tretë ka të bëjë me amuletet (hajmalitë), ku sipas studiuesit na e sqaron se bartja e hajmalive është një dukuri e cila ka rezultuar qysh moti, që nga paleoliti e deri më sot, njerëzit mbajnë amulete për tu mbrojtur nga e keqja, për të pasur fat, fuqi, mendjehollësi. Amuletet janë përdorur nga të rriturit dhe të vegjlit. Zakonisht mbajtja e amuletës ka qenë e ndryshme. Njerëzit si amulete kanë përdorur lëkuren e gjarprit, dhëmbin e ujkut, lëkura e ujkut, druri i tisit, druri i frashrit etj. Është shumë interesante se edhe pse në mileniumin e tretë, këto dukuri praktikohen akoma edhe në ditët e sotme me gjithëse mënyra e besimit ka ndryshuar. Ka njerëz që këto amulete i përdorin si dekorim, mirëpo ka edhe të atillë që këto amulete i përdorin për t'i pasur në funksion të mbrojtjes. Gjatë punës në terren rastisë të shohësh individ që amuletet i mbajnë edhe si sekret nga njerëzit ku jetojnë. Besohet që po i zbuloj kush amuletin ai e humbë funksionin e tij.

Kapitulli i katërt ka të bëjë me shërimin nga syri i keq. Mendoj se edhe në këtë kapitull autori zbardh dukuri mjaft interesante, siç e kemi shërimi me anë të larjes apo spërkatjes, shërimi me anë të ilaçeve popullore, shërimi me anë të tymosjes, shërimi

me anë të lutjeve. Pra në këtë rast autori zbërthen një shtresim kulturor në gjenerata duke treguar për këtë dukuri.

Etnologu Bashkim Lajçi në librin e tij jep material të bollshëm, hapë shtigje të reja për studiuesit e tjerë që të merren edhe më shumë me studimin e kësaj fushe, po ashtu ky libër plotëson një zbrazëti sidomos në fushën e trashëgimisë shpirtërore në rajon.

Valon Shkodra
Etnolog

